



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 2, nenit 101 (3), 102 (4), 103 (1 dhe 6) të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës, Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave miraton:

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	
REGULATIVNI AUTORITETI ŽELEZNICA	
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DEPARTIMI: DEPARTOK: DEPARTOK:	NR. PROT. 198
KOMARIT TACEVE: BROJ STRANA: NR OF PAGES	DE MM VVVV: DD MM VVVV: 29/06/2018
PRISTINE / A	

Rregullore Nr. 04/2018 për Caqet e Përbashkëta të Sigurisë (CPS)

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i vlerave të grupit të parë të Cazeve të Përbashkëta të Sigurisë (CPS) të bazuara në vlerat kombëtare referencës, në përputhje me nenin 7 (3) të Direktivës Nr. 2004/49 / EC dhe duke ndjekur metodologjinë e përcaktuar me Vendimin Nr. 2009/460 / EC.

Për qëllime të kësaj rregullore, përkufizimet e Direktivës Nr. 2004/49 / EC, Rregullorja Nr. 91/2003/EC dhe Vendimin Nr. 2009/460 / EC do të zbatohen.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të gjithë menaxherët e infrastrukturës dhe operatorët hekurudhor të cilët operojnë ligjërisht brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Neni 3

Përkufizimet

Caqet e Përbashkëta të Sigurisë janë (CPS) janë një metodë e kontrollit të sigurisë hekurudhore, nëpërmjet përdorimit të mënyrave të zakonshme të matjes dhe vlerësimit të performancës së sigurisë siç janë Vlerat Kombëtare të Referencës.

Neni 4

Vlerat Kombëtare të Referencës

Vlerat Kombëtare të Referencës për Shtetet e ndryshme dhe për kategoritë e ndryshme të rrezikut janë të përcaktuara në kapitullin 1, seksionet nga 1.1 në 1.6 të Shtojcës.

Neni 5

Caqet e Përbashkëta të Sigurisë

1. Sipas Direktivës 2004/49 / EC, Caqet e Përbashkëta të Sigurisë (CPS) duhet të implementohen gradualisht për të siguruar që një nivel i lartë i sigurisë është ruajtur dhe kur dhe ku është e nevojshme dhe e mundur, është përmirësuar. Ato duhet të sigurojnë mundësi për vlerësimin e nivelit të sigurisë si dhe performancën e operatorëve që operojnë në Kosovë.

2. Neni 3 (e) i Direktivës 2004/49 / EC përcakton CPS për nivelet e sigurisë që duhet të arrihen të paktën nga pjesët e ndryshme të sistemit hekurudhor (të tilla si sistemi konvencional hekurudhor, tunelet e gjata hekurudhore apo linja që përdoren vetëm për transportin e mallrave), si dhe nga sistemi si tërësi, e shprehur në kriteret e pranimit të rrezikut. Megjithatë, paragrafi 7 i Vendimit të Komisionit Nr. 2009/460/EC mbi miratimin e një metode të përbashkët të sigurisë për vlerësimin e arritjes së cazeve të sigurisë siç referohet në Nenin 6 të Direktivës 2004/49 / EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (2) thekson se, për shkak të mungesës së të dhënave të harmonizuara dhe të

besueshme për performancën e sigurisë të pjesëve të sistemeve hekurudhore që janë në veprim në Shtetet e ndryshme Anëtare, zhvillimi i grupit të parë të CPS për pjesët e sistemi hekurudhor (siç është sistemi konvencional hekurudhor, tunelet e gjata hekurudhore ose linjat e përdorura vetëm për transportin e mallrave) nuk është i realizueshëm.

3. Neni 7 (3) i Direktivës 2004/49 / EC kërkon që grupi i parë i CPS duhet të bazohet në një ekzaminim të objektivave ekzistues dhe performancës së sigurisë të sistemeve hekurudhore. Sipas metodologjisë së përcaktuar me Vendimin 2009/460 / EC, grupi i parë i CPS duhet të bazohet në Vlerat Kombëtare të Referencës (National Reference Value-NRV) Nr.91/2003/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 dhjetor 2002 mbi statistikat e transportit hekurudhor e te cilat do te jene baze për llogaritjen e CPS edhe ne Kosovë.

4. Grupi i parë i CPS duhet të konsiderohet si një hap i parë i një procesi. Me këtë grup të parë, duhet qe të përgatitet një kornizë e harmonizuar dhe transparente për një monitorim efikas dhe ruajtjen e performancës se sigurisë hekurudhore.

5. Masat e parashikuara në këtë rregullore janë në përputhje me opinionin e Komitetit të përmendur në nenin 27 (1) të Direktivës 2004/49 / EC.

6. Grupi i parë i Caqeve të Përbashkëta të Sigurisë për kategoritë e ndryshme të rrezikut janë të përcaktuara në kapitullin 2 të shtojcës.

Neni 5


Transpozimi

Kjo rregullore transponon vendimin e BE-së me Nr. 2010/409/EU.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Arsim Berisha,
Kryesues i Bordit
Prishtinë: 29/06/2018

SHTOJCË

Si referencë në vazhdim janë të paraqitura vlerat e llogaritura të Caqeve të Përbashkëta të Sigurisë (CPS) në shtetet anëtare të BE-së. Një metodë e këtillë do të përdoret për llogaritjen e Caqeve të Përbashkëta të Sigurisë (CPS) edhe në Kosovë.

1. Vlerat Kombëtare të Referencës (NRV)

1.1. NRV për llogaritjen e rrezikut për udhëtarët (NRV 1.1 dhe NRV 1.2)

Shteti Anëtar	NRV 1.1 (x 10 ⁻⁹) (*)	NRV 1.2 (x 10 ⁻⁹) (**)
Belgjika (BE)	53.60	0.456
Bullgaria (BG)	250.00	2.01
Republika Çeke (CZ)	40.60	0.688
Danimarka (DK)	7.55	0.0903
Gjermania (DE)	10.90	0.11
Estonia (EE)	50.20	0.426
Irlanda (IE)	6.22	0.0623
Greçia (EL)	54.00	0.485
Spanja (ES)	40.90	0.391
Franca (FR)	21.90	0.109
Italia (IT)	55.00	0.363
Letonia (LV)	50.20	0.426
Lituania (LT)	88.60	0.683
Luksemburgu (LU)	28.80	0.225
Hungaria (HU)	250.00	2.01
Holanda (NL)	11.70	0.0941
Austria (AT)	29.00	0.335
Polonia (PL)	127.00	0.939
Portugalia (PT)	33.90	0.267
Rumania (RO)	250.00	2.01
Sllovenia (SI)	11.80	0.175
Sllovakia (SK)	11.70	0.275
Finlanda (FI)	26.80	0.248
Suedia (SE)	5.70	0.0557
Mbretëria e Bashkuar (UK)	6.22	0.0623

(*) NRV 1.1 e shprehur si: Fatalitetet dhe lëndimet e rënda (Fatalities and Weighted Serious Injuries - FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km të pasagjerëve në vit. Tren-km i udhëtarëve është menduar këtu si njësi e trafikut që lidhet vetëm me trenat e udhëtarëve.

(**) NRV 1.2 shprehur si: Numri i viktimave të udhëtarëve (FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i kilometrave (km) të udhëtarëve në vit. FWSI janë të llogaritura në (*) dhe (**) siç përcaktohen me nenin 3 (d) të Vendimit 2009/460 / EC.

1.2. NRV për llogaritjen e rrezikut për punonjësit (NRV 2)

Shteti Anëtar	NRV 2 (x 10 ⁻⁹) (*)
Belgjika (BE)	53.60
Bullgaria (BG)	250.00
Republika Çeke (CZ)	40.60
Danimarka (DK)	7.55
Gjermania (DE)	10.90
Estonia (EE)	50.20
Irlanda (IE)	6.22
Greqia (EL)	54.00
Spanja (ES)	40.90
Franca (FR)	21.90
Italia (IT)	55.00
Letonia (LV)	50.20
Lituania (LT)	88.60
Luksemburgu (LU)	28.80
Hungaria (HU)	250.00
Holanda (NL)	11.70
Austria (AT)	29.00
Polonia (PL)	127.00
Portugalia (PT)	33.90
Rumania (RO)	250.00
Slllovenia (SI)	11.80
Slllovakia (SK)	11.70
Finlanda (FI)	26.80
Suedia (SE)	5.70
Mbretëria e Bashkuar (UK)	6.22

(*) NRV 2 e shprehur si: Numri i punonjësve të vdekur dhe dëmtimeve të rënda (FWSI) në vit, që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit. FWSI janë menduar këtu, siç përcaktohet me nenin 3 (d) të Vendimit 2009/460 / EC.

1.3. NRV për rrezikun për përdoruesit e kalimit në nivel (vendkalimit) (NRV 3.1 dhe NRV 3.2)

Shteti Anëtar	NRV 3.1 (x 10 ⁻⁹) (*)	NRV 3.2 (x 10 ⁻⁹) (**)
Belgjika (BE)	143.0	n.a
Bullgaria (BG)	124.0	n.a
Republika Çeke (CZ)	302.0	n.a
Danimarka (DK)	55.9	n.a
Gjermania (DE)	69.9	n.a
Estonia (EE)	168.0	n.a
Irlanda (IE)	31.4	n.a
Greqia (EL)	743.0	n.a
Spanja (ES)	131.0	n.a
Franca (FR)	78.9	n.a
Italia (IT)	50.7	n.a
Letonia (LV)	240.0	n.a
Lituania (LT)	530.0	n.a
Luksemburgu (LU)	97.3	n.a
Hungaria (HU)	244.0	n.a
Holanda (NL)	128.0	n.a
Austria (AT)	181.0	n.a
Polonia (PL)	264.0	n.a
Portugalia (PT)	508.0	n.a
Rumania (RO)	124.0	n.a
Sllovenia (SI)	365.0	n.a
Sllovakia (SK)	249.0	n.a
Finlanda (FI)	151.0	n.a
Suedia (SE)	74.2	n.a
Mbretëria e Bashkuar (UK)	23.0	n.a

(*) NRV 3.1 shprehur si: Numri i përdoruesve të kalimit në nivel (FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit.

(**) NRV 3.2 shprehur si: Numri i përdoruesve të kalimit të nivelit (FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / [(Numri i tren-km në vit × Numri i kalimeve në nivel) / Binarë-km]. Të dhënat për numrin e kalimeve në nivel dhe të binarë-km nuk kanë një besueshmëri të përshtatshme në kohën e nxjerrjes së të dhënave (shumica e vendeve raportojnë të dhënat e Indikatorëve të Përbashkët të Sigurisë-IPS-së në linjë-km në vend të binarë-km). FWSI janë të destinuara në (*) dhe (**) siç përcaktohen me nenin 3 (d) të Vendimit Nr. 2009/460 / EC.

1.4. NRV për rrezik ndaj personave te klasifikuar si 'të tjerët' (NRV 4)

Shteti Anëtar	NRV 4 (x 10 ⁻⁹) (*)
Belgjika (BE)	1.90
Bullgaria (BG)	6.45
Republika Çeke (CZ)	5.28
Danimarka (DK)	10.30
Gjermania (DE)	4.41
Estonia (EE)	18.50
Irlanda (IE)	6.98
Greqia (EL)	6.45
Spanja (ES)	4.93
Franca (FR)	6.98
Italia (IT)	6.98
Letonia (LV)	18.50
Lituania (LT)	18.50
Luksemburgu (LU)	4.43
Hungaria (HU)	6.45
Holanda (NL)	3.16
Austria (AT)	14.20
Polonia (PL)	18.50
Portugalia (PT)	4.93
Rumania (RO)	6.45
Sllovenia (SI)	7.14
Sllovakia (SK)	5.28
Finlanda (FI)	10.30
Suedia (SE)	10.30
Mbretëria e Bashkuar (UK)	6.98

(*) NRV 4 shprehur si: Numri vjetor i FWSI për personat që i përkasin kategorisë të 'tjerët' rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit. FWSI janë menduar këtu, siç përcaktohet me nenin 3 (d) të Vendimit 2009/460 / EC.

1.5. NRV për rrezikun ndaj personave të paautorizuar në mjediset hekurudhore (NRV 5)

Shteti Anëtar	NRV 5 ($\times 10^{-9}$) (*)
Belgjika (BE)	75.5
Bullgaria (BG)	190.0
Republika Çeke (CZ)	657.0
Danimarka (DK)	134.0
Gjermania (DE)	106.0
Estonia (EE)	1850.0
Irlanda (IE)	94.7
Greqia (EL)	906.0
Spanja (ES)	184.0
Franca (FR)	69.7
Italia (IT)	122.0
Letonia (LV)	1520.0
Lituania (LT)	2030.0
Luksemburgu (LU)	83.7
Hungaria (HU)	534.0
Holanda (NL)	28.2
Austria (AT)	117.0
Polonia (PL)	1110.0
Portugalia (PT)	948.0
Rumania (RO)	190.0
Sllovenia (SI)	273.0
Sllovakia (SK)	477.0
Finlanda (FI)	294.0
Suedia (SE)	98.1
Mbretëria e Bashkuar (UK)	94.7

(*) NRV 5 shprehur si: Numri i FWSI ndaj personave të pa autorizuar në mjediset hekurudhore në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / numri i tren-km në vit. FWSI janë menduar këtu, siç përcaktohet me nenin 3 (d) të Vendimit 2009/460 / EC.

1.6. NRV për rrezikun shoqëror (NRV 6)

Shteti Anëtar	NRV 6 (x 10 ⁻⁹) (*)
Belgjika (BE)	273.0
Bullgaria (BG)	364.0
Republika Çeke (CZ)	1010.0
Danimarka (DK)	218.0
Gjermania (DE)	206.0
Estonia (EE)	2320.0
Irlanda (IE)	131.0
Greqia (EL)	1820.0
Spanja (ES)	351.0
Franca (FR)	179.0
Italia (IT)	235.0
Letonia (LV)	1850.0
Lituania (LT)	2510.0
Luksemburgu (LU)	219.0
Hungaria (HU)	1000.0
Holanda (NL)	166.0
Austria (AT)	354.0
Polonia (PL)	1530.0
Portugalia (PT)	1510.0
Rumania (RO)	364.0
Sllovenia (SI)	697.0
Sllovakia (SK)	740.0
Finlanda (FI)	461.0
Suedia (SE)	188.0
Mbretëria e Bashkuar (UK)	131.0

(*) NRV 6 shprehur si: Numri total i FWSI-ve në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit. Numri i përgjithshëm i FWSI-ve është paraqitur këtu si shuma e të gjitha FWSI-ve që merren parasysh për llogaritjen e të gjitha NRV-ve të tjera.

2. Vlerat që i atribuohen grupit të parë të Caqeve të Përbashkëta të Sigurisë (CPS)

Kategoria e Rrezikut	Vlera e CPS (*10 ⁻⁹)		Njësitë Matëse
Rreziku për Udhëtarë	CPS 1.1	250.0	Numri i viktimave të udhëtarëve (FWSI) dhe dëmtimeve të rënda në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km të udhëtarëve në vit
	CPS 1.2	2.01	Numri i viktimave të udhëtarëve (FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i kilometrave (km) të udhëtarëve në vit
Rreziku për punonjësit	CPS 2	77.9	Numri i punonjësve të vdekur dhe dëmtimeve të rënda (FWSI) në vit, që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit
Rreziku për përdoruesit e kalimit në nivel	CPS 3.1	743.0	Numri i përdoruesve të kalimit në nivel (FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit
	CPS 3.2	n.a. (*)	Numri i përdoruesve të kalimit të nivelit (FWSI) në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / [(Numri i tren-km në vit × Numri i kalimeve në nivel) / Binarë-km]
Rreziku ndaj të tjerëve	CPS 4	18.5	Numri vjetor i FWSI për personat që i përkasin kategorisë 'tjerët' rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit
Rreziku ndaj personave të paautorizuar në mjediset hekurudhore	CPS 5	2030.0	Numri i FWSI ndaj personave të paautorizuar në mjediset hekurudhore në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / numri i tren-km në vit
Rrezik për të gjithë shoqërinë	CPS 6	2510.0	Numri total i FWSI-ve në vit që rrjedhin si pasojë e aksidenteve të rënda / Numri i tren-km në vit

(*) Të dhënat mbi numrin e kalimeve në nivel dhe binarë-km, të cilat janë të nevojshme për të llogaritur këtë CPS, në kohën e nxjerrjes së të dhënave nuk kishin një besueshmëri të duhur (p.sh. shumica e shteteve anëtare raportojnë linjë-km në vend të binarë-km, etj).